



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 49, datë 14.04.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË**  
**QIRASË TË MBETURA TË PASTREHA SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË**  
**TYRE NË ZBATIM TË PROJEKTIT TË RINDËRTIMIT - SHESHI DYZH, ZONA 4**  
**DURRËS - SPITALLË**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, Aktit normativ nr.8, datë 07.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, VKM-së nr. 164, datë 19.02.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre, në zbatim të projektit të rindërtimit - Sheshi DYZH, Zona 4 Durrës – Spitalle, si më poshtë vijon:

| Nr. rendor | Emër / Atësi / Mbiemri | Gjendja familjare | Njësia Administrative nga vjen kërkesa |
|------------|------------------------|-------------------|----------------------------------------|
| 1          | Mirjana Zef Kuliçaj    | 4                 | Njësia Administrative nr. 6            |
| 2          | Agron Ramiz Murati     | 7                 | Njësia Administrative nr. 6            |
| 3          | Naze Ahmet Kalia       | 5                 | Njësia Administrative nr. 6            |
| 4          | Afrim Hamit Pasha      | 5                 | Njësia Administrative nr. 6            |
| 5          | Farie Ahmet Kalia      | 8                 | Njësia Administrative nr. 6            |
| 6          | Ledjan Sef Dauti       | 3                 | Njësia Administrative nr. 6            |


- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 14.04.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 271/prot.  
5



Durrës, më 16.04.2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.49 datë 14.04.2021 “Për miratimin e listës së familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë të mbetura të pastreha si pasojë e shembjes së banesave të tyre në zbatim të projektit të rindërtimit – sheshi Dysh-, zona 4 Durrës Spitallë.”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

